



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:090117
Datë: 18.09.2024
Numri i dokumentit: 06178794

C.nr. 669/22.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Migjen Kastrati, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve Kosova e Re, në Likuidim e përfaqësuar nga Likuidatori N.L, në Prishtinë, Rr. K.B, B1, Nr..., kundër të paditurit Rr.K, nga fshati L, Komuna e Pejës, me bazën juridike, për regresimin e mjeteve në emër të kompensim i dëmit jo materialë dhe materiale, vlera e kontestit 1,745.50 euro, jashtë seancës me datën 18.09.2024 bie këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditëses Kompania e Sigurimeve Kosova e Re, në Likuidim e përfaqësuar nga Likuidatori N.L, në Prishtinë, Rr. K.B, B1, Nr..., me numër C.nr. 669/22 e datës 05.05.2022 e ushtruar kundër të paditurit, Rr.K, nga fshati L, Komuna e Pejës, me bazën juridike, për regresimin e mjeteve në emër të kompensim i dëmit jo materialë dhe materiale, vlera e kontestit 1,745.50 euro.

A r s y e t i m

Paditësja pranë kësaj gjykate me datën 05.05.2022 ka parashtruar padi kundër të paditurit me bazën juridike për regresimin e mjeteve në emër të kompensim i dëmit jo materialë dhe materiale, vlera e kontestit 1,745.50 euro.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë dhe provave prezentë në lëndë, ka konstatuar se paditësi padisë nuk i ka bashkangjitur vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar e që kërkohet në kuptim të dispozitës së nenit 253.4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore - LPK-së.

Gjykata duke vepruar sipas padisë së paditëses ia ka dërguar vërejtjen për pagesën e taksës e datës 11.05.2022, ashtu që e njëjta me anë të parashtrësë se datës 24.05.2022 sa i përket kërkesë se gjykatës për vërejtjen pagesë se taksës gjyqësore ka kërkuar nga gjykata ti dërgojë urdhërpagesat nga KGJK- së, në 4 kopje që të beje pagesën e taksës gjyqësore për padi.

Gjykata konstaton se paditësja ka pranuar vërejtjen për pagesën e taksës për padi duk u bazua në konstatimin e saj si në parashtrëse e saj të lartcekur e datës 24.05.2022 mirëpo në afatin e përcaktuar për pagesën taksës sipas vërejtjes për pagesën e taksës në afat prej 15 ditësh gjykatës

nuk i ka dorëzuar dëshmi për pagesë bërë e duk u njoftuar për pasojat e mos pagesës së taksës. Deklarimet respektivisht kërkesat të tjera të theksuar në parashtrësën e palës paditëse gjykata nuk i morri parasysht.

Gjykata ka vepruar në kuptim të Udhëzimit Administrativ NR.02/2017 për Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore dhe paditëses i ka dërguar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për padi, sipas nenit 5, 5.2, 5.3 dhe 5.5, 5.5.2 i këtij Udhëzimi Administrativ dhe në bazë të dispozitës së nenit 253 pika 4 e 5 të LPK-së.

Sipas dispozitës së nenit 253.1, të LPK-së shprehimisht parashihet se çka duhet të përmbajë padia, ndërsa sipas dispozitës së nenit 253.4, të këtij ligji shprehimisht parashihet se ‘paditësi ka për detyrë që padisë t’i bashkëngjisë vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar’, ndërsa sipas dispozitës së nenit 253.5 të këtij ligji, shprehimisht parashihet se ‘në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padi, e as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga pagimi i taksës gjyqësore do të konsiderohet se padia është e tërhequr.’

Meqenëse pala paditëse nuk ka vepruar në kuptim të vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore për padi dhe gjykatës nuk i ka dorëzuar kërkesë - prova që ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore për padi, e duke u mbështetur në depozitat e nenit 253.1, 4 dhe 5, dhe nenin 387.1, pika w), të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:090117,C.nr.669/22 i dt. 18.09.2024

G j y q t a r i
Migjen Kastrati

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate